



Information about  
elections  
[electionsfinland.fi](http://electionsfinland.fi)

## Zgjedhjet parlamentare 2019

Zgjedhjet parlamentare mbahen në çdo katër vjet.  
Në zgjedhje qytetarët e Finlandës  
zgjedhin 200 deputetë në parlament  
për të vendosur për çështjet tona të përbashkëta.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2019 mbahen  
të dielën më 14.4.2019.

Votimi paraprak në Finlandë është më 3.-9.4.2019  
ndërsa jashtë vendit më 3.-6-4-2019.

### Detyrat e parlamentit

Detyra më e rëndësishme e parlamentit është që të vë ligjet,  
në bazë të të cilave funksionon shoqëria.

Detyrë tjetër e rëndësishme e parlamentit  
është që të vendosë për buxhetin e shtetit.

Në buxhet caktohet se,

nga i merr paratë shteti dhe për çka përdoren ato para.

Parlamenti gjithashtu mbikëqyrë përdorimin e parave të shtetit

Parlamenti zgjedhë kryeministrin

e qeverisë së shtetit

dhe mbikëqyrë punën e qeverisë.

Pos këtyre parlamenti vendosë,

se cili është mendimi i Finlandës

rreth shumë çështjeve të Bashkimit Europian.

### Kush ka të drejtë të votojë?

Ti mund të votosh në zgjedhjet parlamentare, nëse

- je shtetas/e i/e Finlandës; dhe
- ke mbushur 18 vjet jo më vonë se 14.4.2019.

## **Lajmërimi për të drejtën e votimit vjen në shtëpi**

Nëse ti ke të drejtë votimi,  
për atë të vjen një letër në shtëpi.

Në letër është lajmërimi për të drejtën e votimit,  
në të cilin janë të dhënat për vendvotimin tënd në ditën e zgjedhjeve.  
Aty janë gjithashtu të dhënat mbi vendet e votimit paraprak.

## **Kë mund ta votosh?**

Finlanda është e ndarë në 13 qarqe zgjedhore.

Secili qark zgjedhor ka kandidatët e vet.

Mund ta votosh personin,

që është kandidat në zgjedhjet parlamentare  
në qarkun tënd zgjedhor.

Qarku yt zgjedhor tregohet në lajmërimin për të drejtë votimi.

Secili kandidat ka numrin e vet të kandidatit.

Numrat e kandidatëve të qarkut tënd zgjedhor  
shihen ndër të tjerash edhe në vendvotime.

Informacione mbi kandidatët mund të marrësh për shembull nga  
gazetat, televizioni dhe nga interneti.

## **Votimi në shtëpi**

Nëse je invalid i rëndë

ose je i sëmurë kohë të gjatë,

mund të votosh paraprakisht në shtëpi.

Ti duhet të lajmërohesh për votim në shtëpi

deri më 2.4.2019

pranë komisionit qendror zgjedhor në komunën tënde.

Numri i telefonit të komisionit gjendet në lajmërimin për të drejtë vote.

Rreth votimit në shtëpi mund të marrësh

informacione shitesë nga komisioni zgjedhor.

## **Kështu votohet paraprakisht**

Në zgjedhjet parlamentare mund të votosh paraprakisht

në cilindo vendvotim të votimit paraprak

në Finlandë ose në botën e jashtme.

Kur të shkosh për të votuar merr me vete një dokument identifikimi  
për shembull pasaportën, letërnjoftimin ose patentën e shoferit.

1. Tregoja dokumentin e identifikimit anëtarit të komisionit.  
Anëtari i komisionit e kontrollon atë  
dhe të jep ty fletëvotimin.
2. Shko në kabinë të votimit.  
Në fletëvotim shkruaj qartë  
numrin e atij kandidati, të cilin e voton.  
Mos shkruaj asgjë tjetër  
në fletëvotim.
3. Palos fletëvotimin nga mesi.
4. Kthehu te anëtari i komisionit zgjedhor.  
Ai/ajo e vulosë fletëvotimin  
dhe të jep ty një zarf votimi me ngjyrë kafe.  
Fut fletëvotimin në zarf  
dhe mbyll zarfin me ngjitës.
5. Anëtari i komisionit zgjedhor të udhëzon  
për të nënshkruar formularin.  
Me anë të nënshkrimit ti garanton se  
e ke plotësuar vet fletëvotimin,  
ke marrë vulën në të  
dhe e ke mbyllur atë në zarf.
6. Në fund, anëtari i komisionit i mbyll zarfin e votimit dhe formularin  
në një zarf dërgues me ngjyrë të verdhë.

Pasi të kesh votuar, mund të largohesh nga vendvotimi.

### **Kështu votohet në ditën e zgjedhjeve**

Ditën zgjedhjeve më 14.4.2019 vendvotimet janë hapur nga ora 9–20.

Shiko në kartën e lajmërimit

ku gjendet vendvotimi yt.

Mund të votosh vetëm në atë vendvotim,

që shkruan në lajmërimin për të drejtën e votimit.

Kur të shkosh për të votuar merr me vete një dokument identifikimi,  
për shembull pasaportën, letërnjoftimin ose patentën e shoferit.

1. Tregoja dokumentin e identifikimit anëtarit të komisionit.  
Anëtari i komisionit e kontrollon atë

dhe të jep ty fletëvotimin.

2. Shko në kabinë të votimit.  
Në fletëvotim shkruaj qartë numrin e atij kandidati, të cilin e voton.  
Mos shkruaj asgjë tjetër në fletëvotim.
3. Palos fletëvotimin nga mesi.
4. Kthehu te anëtari i komisionit zgjedhor.  
Ai/ajo e vulosë fletëvotimin.
5. Hedh fletëvotimin në kutinë e votimit.

Pasi të kesh votuar, mund të largohesh nga vendvotimi.

### **Kush mund të të ndihmojë?**

Anëtarët e komisionit zgjedhor të këshillojnë në vendvotim gjatë votimit paraprak dhe në ditën e zgjedhjeve.

Në vendvotim ka gjithashtu edhe asistent të votimit.  
Mund ta lusësh atë që të vijë me ty në kabinën e votimit nëse nuk ia del vet që të plotësosh fletëvotimin.

Si asistent i votimit mund të veprojë edhe ndonjë person i zgjedhur nga ti, për shembull ndonjë familjar ose i afërm i yti.  
Mirëpo asistent nuk ka të drejtë të jetë kandidati ose ndonjë i afërm i tij.  
Asistenti i votimit nuk guxon t'i tregojë askujt se kë e ke votuar.

### **Sekreti zgjedhor**

Secili vendosë vet se a do të votojë dhe kë do ta votojë.

Sekreti zgjedhor nënkupton edhe atë, që ti nuk ke nevojë t'i tregosh askujt se kë e voton.

Voto në zgjedhjet parlamentare!

Në këtë broshurë tregohet në gjuhë të qartë, rreth votimit dhe rreth zgjedhjeve parlamentare 2019.

Informacione shtesë rreth votimit:

[vaalit.fi](http://vaalit.fi)

[selkokeskus.fi](http://selkokeskus.fi)

Ministria e drejtësisë (Oikeusministeriö)

Selkokeskus